



**PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
AGJENCINË E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtëj e tutje AP) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. AP-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASCAL, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.ascal.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menu-të ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e ASCAL është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së ASCAL janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: ASCAL ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e ASCAL dhe përkatësisht: Ligji Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë, Standardet shtetërore të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe në standardet dhe udhëzimet përkatëse të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe atë ndërkombëtare të arsimit të lartë, Rregulloren e Sistemit të Akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, miratuar me Vendim Nr.424, datë 02.6.2010 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të APAAL.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ASCAL vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.ascal.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfutur ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti

publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

- AP-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË ASCAL

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja a/d	Funksionet dhe detyrat e ASCAL janë përshkruar tek vendim i KM nr. 109, datë 15.02.2017 Përshkrimi i strukturës organizative jepet në vendimin e Km nr. 171, datë 27.09.2010	Pas botimit në fletore zyrtare. Përditësohet pas çdo akt emërimi.	https://www.ascal.al/sq/rreth-nesh/legjislacioni	Spektori i Shërbimit dhe Publikimit
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja b	Baza ligjore e ASCAL Raporte, manuale dhe udhërrëfues të ENQA, EQAR, CEENQA, INQAAHE	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare Menjëherë pas finalizimit të përkthimit	https://www.ascal.al/sq/rreth-nesh/legjislacioni https://www.ascal.al/sq/informacione	Spektori i Shërbimit dhe Publikimit

		Vendimet e Ba	Menjëherë pas firmosjes nga BA	https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet	
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja c/g	Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik” Neni 7, pika 1, shkronja c Koordinatori për të drejtën e informimit Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve Programi i transparencës	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare 48 orë pas emërimit Në mënyrë të vazhdueshme 48 orë pas miratimit	https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/168-programi-i-transparences-ascal https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/169-koordinatori https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/40-programi-i-transparences https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/168-programi-i-transparences-ascal	Koordinatori për të drejtën e informimit
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të ASCAL, orarin e punës Emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja ç	Adresa e agjencisë dhe orari i punës Emri dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit	48 orë pas miratimit 48 orë pas miratimit	www.ascal.al https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/169-koordinatori	Spektori i Shërbimeve dhe Publikimeve Koordinatori për të drejtën e informimit
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja d	Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 14, pika 6	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare	https://www.ascal.al/sq/rreth-nesh/legjislacioni	Spektori i Shërbimeve dhe Publikimeve

procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.					
Mekanizmat monitorues; raporte auditi; dokumentet me tregues performance Buxheti	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja dh Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja e	Raport mbi auditimin financiar të ushtruar në ASCAL Raporti i monitorimit të buxhetit	48 orë pas marrjes së raportit 48 orë pas dërgimit nga ministria përgjegjëse për arsimin	https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi	Spektori i Shërbimeve dhe Publikimeve
Informacion për procedurat e prokurimit.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja ë	Regjistri i realizimit të prokurimeve Regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitin vijues	Menjëherë pas dërgimit në APP Menjëherë pas dërgimit në APP	https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi	Spektori i Shërbimeve dhe Publikimeve
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja ë f				
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja ë gj				
Mbajtja e dokumentacionit nga AP	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja ë h	Rregullore e brenshme Rregullore e arkivës	Menjëherë pas miratimit të saj Menjëherë pas miratimit të saj	https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi https://www.ascal.al/sq/informacione/administrimi	Spektori i Shërbimeve dhe Publikimeve

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja i	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Në mënyrë të vazhdueshme	https://www.ascal.al/sq/programi-i-transparences/item/168-programi-i-transparences-ascal	Koordinatori për të drejtën e informimit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja /k	Baza ligjore e ASCAL Kodi i Cilësisë Manuali i procedurave dhe afateve	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare Menjëherë pas miratimit të tij	https://www.ascal.al/sq/rreth-nesh/legjislacioni https://www.ascal.al/sq/sigurimi-i-cilesise/kodi-i-cilesise https://www.ascal.al/sq/sigurimi-i-cilesise/kodi-i-cilesise	Sektori i Shërbimeve dhe Publikimeve
Informacione të tjera të dobishme	Ligji nr. 119/2014 Neni 7, pika 1, shkronja l	Botime Publikime	Në mënyrë të vazhdueshme Në mënyrë të vazhdueshme	https://www.ascal.al/sq/informacione/publikime https://www.ascal.al/sq/informacione/publikime	Sektori i Shërbimeve dhe Publikimeve

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ASCAL vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.ascal.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

DHURATA BOZO

DREJTOR